

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft, Gjermani do të fitoj kontroll mbi Levi Reli Centar Oj Finlandë**

**(lënda nr. 08-114/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 08.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim ku **Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft** (Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft), me seli të regjistruar në Porsheplac 1, D-70435 Shtuttgart, Gjermani, direkt ose indirekt nëpërmjet një shoqërie të varur në pronësi të plotë, do të fitojë kontrollin mbi Levi Reli Center Oj (Levi Rally Center Oy), me seli në Lillukka 14, 96190 Rovaniemi, Finlandë, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**Dr. Ing. h.c. F. Porshe Akciegezellshaft** është një prodhues gjerman i automobilave dhe pjesë e Grupit Folksvagen ("Grupi Folksvagen"), i specializuar në makina sportive, SUV dhe sedan me performancë të lartë. Grupi Folksvagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e makinave të udhëtarëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, shasive të autobusëve dhe motorëve me naftë motoçikletave, duke përfshirë edhe pjesë rezervë dhe pajisje shtesë. Grupi Folksvagen është gjithashtu i angazhuar në shpërndarjen e automjeteve. Grupi Folksvagen përfshin markat e automjeteve Folksvagen Pesinxher Kars, Folksvagen Lajt Komrshal, Porshe, Audi, Shkoda, Bentley, Lamborgini, SEAT, MAN, Skania dhe Dukati. Grupi Folksvagen ofron gjithashtu shërbime të lëvizshmërisë, të tilla si automjetet në thirrje (ride hailing) dhe ndarjen e automjeteve (car sharing).

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura si më poshtë:

- Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- Porshe Broker SHA Skopje, me seli të regjistruar në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- Skania Makedonia SHPKNJP Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup
- Porshe Makedonia SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinë nr. 4, Shkup

Veprimtaria parësore e shoqërive të përmendura në Maqedoninë e Veriut është tregtia me automjete motorike dhe lizingut financiar.

**Levi Reli Centar Oj** nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në tregun e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si treg relevant, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përkufizohet **si treg për kapacitetet e testimin të automjeteve në kushte dimërore**.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

08.08.2023

Shkup